



**KRYETARI I KOMUNËS**  
**MUNICIPAL PRESIDENT**  
**PRESDENNIK OPSTINE**

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

DATA/DATUM/DATE	22.10.2024
NR/BR. 01.	327/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës Agim Altun
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027;

Në bazë të dispozitave të nenit 12, pika 12.1 dhe 12.2, shkronja "c", nenit 40, pika 40.2 shkronjat "a" dhe "h", nenit 58, shkronja "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 19 pika 1 të UA (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, nenit 25, paragrafi 2, pika 2,3, 2.11, nenit 51 pika 2.9, të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës këtë:

### PROPOZIM - VENDIM

Për Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027.

### ARSYETIMI

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027 është të ndihmojë në fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve të komunës së Ferizajt. Ky dokument synon të ofrojë mundësi trajnimi dhe zhvillimi personal për të rinjtë, duke rritur aftësitë e tyre për të qenë qytetarë aktivë dhe produktivë në shoqëri.